

DHOMA E POSAÇME E  
GJYKATËS SUPREME TË  
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE  
QË LIDHEN ME  
AGJENSINË KOSOVARE  
TË PRIVATIZIMIT

SPECIAL CHAMBER OF  
THE SUPREME COURT  
OF KOSOVO ON  
PRIVATISATION AGENCY  
OF KOSOVO RELATED  
MATTERS

POSEBNA KOMORA  
VRHOVNOG SUDA  
KOSOVA ZA PITANJA  
KOJA SE ODOSE NA  
KOSOVSKU AGENCIJU  
ZA PRIVATIZACIJU

---

C-II.-13-0450-C0001

*Paditësi:*

1. **A.K.**, Prishtinë.

kundër

*Të paditura:*

Ndërmarrja Shoqërore “T”, të cilën administron *Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Agim Ramadani”, Nr. 23, Prishtinë.*

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Teuta Ibrahim, më 23 shtator 2019, lëshon këtë:

## **A K T V E N D I M**

1. **Dhoma e Posaçme nuk ka juridiksion mbi këtë lëndë.**
2. **Lënda i kthehet Gjykatës Themelore në Mitrovicë.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me datën 10 qershor 2009, paditësi ka ushtruar padi në Gjykatën Komunale në Mitrovicë, për anulimin e vendimit mbi shqiptimin e masës disiplinore – Ulje në pozitë (degradim). Paditësi thekson se me të paditurën është në marrëdhënie pune prej vitit 1979. Në vitin 2009

është caktuar në vendin e punës si zëvendës menaxher i divizionit të industrisë dhe përpunimit me të ardhura personale prej 850 euro. Këtë detyrë e kishte ushtruar deri më 05 mars 2009, kur është suspenduar nga menaxheri i Ndërmarrjes Shoqërore “T”, në Mitrovicë. Suspendimi i paditësit ishte bërë me arsyetimin se nuk i ka respektuar detyrat dhe obligimet e punës, ka keqpërdorë detyrën zyrtare dhe nuk ka respektuar urdhëresën e menaxherit. Paditësi kishte shfrytëzuar të drejtat e ankesës brenda ndërmarrjes por pa sukses. Komisioni disiplinor në bazë të të gjeturave kishte shqiptuar masën disiplinore ulje në pozitë – degradim.

Paditësi ka ushtruar padi duke pretenduar se vendimi për shqiptimin e masës disiplinore dhe vendimet tjera të nxjerr nga Menaxhmenti i ndërmarrjes janë të kundërligjshme sepse siç thekson paditësi nuk mbështeten në asnjë dispozitë ligjore as me ndonjë provë eventuale. Paditësi thekson se vendimet në fjalë janë nxjerr në formë arbitrare dhe duke shkelur ligjin dhe procedurën disiplinore. Paditësi kërkon nga gjykata që të aprovet kërkesëpadija e tij si e bazuar dhe të anulohet vendimi për shqiptimin e masës disiplinore ulje në pozitë – degradim të komisionit disiplinor të obligohet e paditura ta kthej në vendin e punës në pozitën e mëparshme dhe njëherit të ia kompensoj paditësit diferencat në të ardhura personale me kamate prej 3.5% deri te pagesa e përgjithshme si dhe i kërkon shpenzimet procedurale.

Me datën 17 tetor 2013, Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktvendimin C.nr.645/2013, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike. Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi lënda i dërgohet Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, si gjykatë me kompetencë lëndore për vendosjen e kësaj çështjeje kontestimore.

Me datën 29 nëntor 2013, Dhoma e Posaçme ka pranuar shkresat e lëndës nga Gjykata Themelore në Mitrovicë ( lënda C.nr.645/2013) përmes një akti përcjellës të dt. 26 nëntor 2013.

Me datën 25 shkurt 2016, gjyqtari i DHPGJS, padinë së bashku me dokumentacionin përcjellës i dërgon të paditurës AKP-së në mbrojtje.

Duke iu përgjigjur urdhrin të gjykatës, e paditura AKP më datën 16 mars 2016, ka paraqitur mbrojtjen në padinë e paditësit. AKP-ja si përfaqësuese ligjore e të paditurës i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit në padi duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj, dhe si të tillë duhet të refuzohet padia si e pa bazuar.

Për detaje tjera referimi bëhet tek dosja e lëndës.

### **Arsyetimi Ligjor:**

Gjykata ka vendosur që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës nuk ka juridiksion mbi këtë lëndë për shkak të Ligjit të miratuar më 8 tetor 2012 për Trepçën nr. 05/L-120 (Gazeta Zyrtare nr. 36 e datës 31 tetor 2016).

Lënda duhet të dërgohet tek Gjykata Themelore në Mitrovicë.

Prandaj, është vendosur sikurse në diapozitivin e këtij Aktvendimi.

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Teuta Ibrahim** – Gjyqtare

\_\_\_\_\_